



## UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA"

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr 03/1461 Dt. 06 / 10 /2020

Ne baze te nenit 2 te Udhëzimit Administrativ te Masht-it, nr.17/2014 dhe nenit 2 te Udhëzimit Administrativ te Masht-it për kategoritë e studenteve për asistence si dhe kushtet për fitimin e asistencës, nr.24/2012, si dhe nenit 31 te Ligjit nr. 4/L-261 për Veteranet e Luftës se Ushtrisë çlirimtare te Kosovës - Universiteti "Kadri Zeka" në Gjiilan shpall:

### K O N K U R S

Për lirim nga pagesa e semestrit për studentet e Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan për vitin akademik 2020/2021

Te drejtë lirimi nga pagesa e semestrit për vitin akademik 2020/2021 kane Studentet e Universitetit Publik „Kadri Zeka" (shtetas të Republikës se Kosovës):

1. Studentët, familjet e të cilëve janë ne asistence sociale si dhe studentët familjet e të cilëve nuk kanë asnjë burim të të ardhurave;
2. Studentët të cilët janë invalidë dhe veteran të luftës ose janë fëmijë te veteranëve apo invalidëve te luftës ;
3. Studentët që kanë mbetur pa njërin prind si pasoje e luftës;
4. Studentët me aftësi te kufizuara fizike;
5. Dy e më shumë studentë të të njëjtës familje të cilët studiojnë në universitetet publike ( studenti i dytë lirohet nga pagesa).

Për t'u liruar nga pagesa studentët paraqesin:

1. Për kategorinë e studentëve qe janë ne asistencë sociale nevojitet ose studentet familjet e të cilëve nuk kanë asnjë burim të të ardhurave:
  - 1.1. Vërtetimi nga Qendra për Punë Sociale, me të cilin vërtetohet se familja e studentit është përfituese e ndihmave sociale .
  - 1.2 Vërtetimin nga Enti për punësim me të cilin vërtetohet se asnjë nga anëtarët e familjes së tij nuk janë në marrëdhënie pune si dhe vërtetimin nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa te Kuvendit Komunal me të cilin dëshmohet se asnjëri nga anëtarët e familjes së ngushtë nuk ngarkohet me tatim nga të ardhurat kadastrale apo se nuk ushtrojnë veprimtari biznesi
  - 1.3. Vërtetim nga Fakulteti, për statusin e studentit.



2. Për studentët të cilët janë invalid dhe veteran të luftës nevojitet:
  - Certifikata e mjekut specialist dhe
  - Vërtetimi nga shoqata e invalidëve dhe veteraneve të luftës
  - Vërtetimi nga Fakulteti për statusin e studentit.
  
3. Studentët që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës;
  - Certifikatën nga zyra e regjistrimit civil të Kuvendit Komunal si dëshmi për humbjen e prindit në luftë;
  - Vërtetimin se nuk ushtron veprimtari biznesi pjesa tjetër e familjes dhe
  - Certifikatën e lindjes se aplikuesit (studentit/ës)
  - Vërtetimi nga Fakulteti për statusin e studentit.
  
4. Studentet me aftësi të kufizuara fizike;
  - Studentët me nevoja të veçanta për të përfituar asistencë sociale duhet të paraqesin certifikatën e mjekut specialist me të cilin dëshmohet aftësia e tij e kufizuar fizike.
  - Vërtetimi nga Fakulteti për statusin e studentit.
  
5. Dy e më shumë studentë të të njëjtës familje të cilët studiojnë në universitetet publike ( studentit i dytë lirohet nga pagesa)
  - Kopjen e fletëpagesës dhe kopjen e ID kartelës
  - Vërtetimin që ka regjistruar semestrin në vitin akademik 2020/2021

#### PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Te gjithë studentet te cilët aplikojnë për asistencë konform kushteve te parapara sipas UA të MASHT-it nr. 24/2012 dokumentet e kërkuar duhet t'i dorëzojnë në njësitë përkatëse akademike nga data 06.10.2020 deri me datë 13.10.2020

Lista e të liruarve nga pagesa do të shpallet në ueb faqen e Universitetit [www. uni-gjilan.net](http://www.uni-gjilan.net)

